



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në Nenin 57, Shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-391, si dhe bazuar në Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në funksion të rritjes së cilësisë së arsimit në Komunën e Prishtinës, me qëllim që të rritet niveli i transparencës me rastin e punësimit të stafit udhëheqës në institucionet edukativo-arsimore e aftësuese (IEAA) të kësaj komune, në mënyrë që sa më shumë që të jetë e mundur të minimizohet politizimi, familjarizmi dhe joprofesionalizmi në fushën e arsimit, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) merr:

V E N D I M

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINËS - OPŠTINA PRIŠTINA
DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË-DIREKCIJA ZA PROSVETU I KULTURU

PËR PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES

03 Nr./Br. 53 Dt. 30.06.2014

SË DREJTORIT DHE ZËVENDËSDREJTORIT NË IEAA

Përzgjedhja e kandidatëve për drejtorë ose zëvendësdrejtorë të IEAA do të bëhet në përputhje me Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës (UA Nr. 08/2014).

Procedura e përzgjedhjes është si vijon:

Së paku një muaj para fillimit të procesit të përzgjedhjes së drejtorit a zëvendësdrejtorit, DKA e njofton në formë të shkruar MASHT-in dhe Këshillin Drejtues të IEAA-së përkatës për planin dhe datat e realizimit të përzgjedhjes së drejtorit a zëvendësdrejtorit. Ndërsa, MASHT dhe Këshilli Drejtues i IEAA-së në afat prej 7 ditësh pas marrjes së njoftimit, e informojnë DKA-në për përfaqësuesit përkatës që do të marrin pjesë në Komisionin Përzgjedhës.

I gjithë procesi i përzgjedhjes së drejtorit a zëvendësdrejtorit, që prej ditës së mbylljes së konkursit e deri te emërimi i drejtorit a zëvendësdrejtorit, duhet të përmbyllet brenda 45 ditëve.

Hapet konkursi publik me kriteret, me kushtet dhe me të gjitha sqarimet e nevojshme për kandidatët e interesuar.

Konkursi shpallet në së paku në dy gazeta ditore dhe në ueb faqen e Komunës së Prishtinës dhe duhet të jetë i hapur 15 ditë.

Me rastin e publikimit të konkursit, në ueb faqen e komunës publikohet edhe dokumenti ku përshkruhet procedura e përzgjedhjes. Për këtë informohen kandidatët përmes konkursit, në mënyrë që të gjithë të kenë qasje në këtë dokument.

Kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin e tyre në përputhje me kërkesat e konkursit.

Që prej shpalljes së konkursit e deri me rastin e intervistimit, të gjithë kandidatëve për drejtorë a zëvendës drejtorë u ofrohet qasje në të dhënat e IEAA-së ku ata konkurrojnë dhe mund të kenë takime me personelin e atij IEAA, në mënyrë që të mund të përgatiten për konkurs dhe për intervistë.

Gjatë kohës sa është i hapur konkursi pranohen të gjitha aplikacionet e kandidatëve.

Aplikacionet së bashku me të gjitha dokumentet përcjellëse dorëzohen në DKA përmes protokollit.

Aplikacionet e pakompletuara sipas kërkesave të konkursit dhe kandidatët e pakualifikuar sipas ligjeve dhe UA të sipërpërmendura nuk merren në shqyrtim.

Procesi i përzgjedhjes së drejtorit a zëvendës drejtorit udhëhiqet nga Komisioni Përzgjedhës (në tekstin e mëtejshëm Komisioni), i cili përbëhet nga 5 anëtarë:

- 3 anëtarë me të drejtë vote (2 anëtarë caktohen nga kryetari i komunës – njëri mundësisht angazhohet një ekspert i pavarur i arsimit – dhe 1 anëtar caktohet nga MASHT), dhe
- 2 anëtarë vëzhgues të Këshillit Drejtues të IEAA-së përkatës (1 prind dhe 1 mësimdhënës).

Nëse për një pozitë të shpallur për drejtor a zëvendës drejtor konkurrojnë më pak se 3 kandidatë që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit, atëherë konkursi përsëritet për herë të dytë.

Nëse për një pozitë të shpallur për drejtor a zëvendës drejtor konkurrojnë 3 deri 5 kandidatë që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit, atëherë të gjithë kandidatët mund të ftohen për intervistimin publik.

Nëse për një pozitë të shpallur për drejtor a zëvendës drejtor konkurrojnë më shumë se 5 kandidatë që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit, atëherë Komisioni bën përzgjedhjen e 3-5 kandidatëve (listën e ngushtë) për intervistim publik.

Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve (listën e ngushtë) për intervistim publik i përcakton Komisioni, duke u bazuar në Planin Zhvillimor 4-vjeçar për zhvillimin e IEAA-së të ofruar nga kandidatët, portfolion profesionale të kandidatëve, kualifikimet, përvojën e punës, letrat e referencës, etj.. Por, Komisioni mund të vendosë edhe për intervistim apo testim të kandidatëve për të përzgjedhur kandidatët për listën e ngushtë që do të ftohen për intervistim publik.

Me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për listën e ngushtë nga Komisioni, DKA obligohet që të ftojë për pjesëmarrje në cilësinë e vëzhguesve përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e arsimit dhe të transparencës së institucioneve publike, si dhe përfaqësues të Komitetit për Arsim të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës.

Pas përzgjedhjes së kandidatëve të listës së ngushtë për intervistim publik nga Komisioni, lista e këtyre kandidatëve publikohet në ueb faqen e komunës, në mënyrë që të gjithë të interesuarit të mund ta shohin se kush është përzgjedhur për intervistim publik.

Pas përzgjedhjes së listës së ngushtë, përgatitet plani i intervistimit publik dhe kontaktohen kandidatët e përzgjedhur dhe informohen për ditën, datën, kohën dhe vendin e intervistimit publik.

Me rastin e intervistimit publik, kandidati për drejtor a zëvendës drejtor të IEAA-së bën mbrojtjen publike, para Komisionit dhe të pranishmëve të tjerë, të Planit Zhvillimor 4-vjeçar për zhvillimin e IEAA-së të ofruar nga kandidati me rastin e konkurrimit dhe i përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të Komisionit.

Përveç Komisionit, me rastin e intervistimit publik të kandidatëve, ftohen për pjesëmarrje në cilësinë e vëzhguesve edhe përfaqësuesit e Këshillit Drejtues të shkollës, të Këshillit të Prindërve të shkollës, të Këshillit të Nxënësve të shkollës, mësimdhënësit, prindërit, anëtarë të komunitetit dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e arsimit dhe të transparencës së institucioneve publike.

DKA e publikon orarin (ditën, datën, kohën dhe vendin) e intervistave publike në ueb faqen e komunës dhe në një gazetë ditore, së paku 5 ditë para mbajtjes së intervistimit publik, në mënyrë që të gjitha palët e interesuara (të sipërpërmendura) të informohen me kohë dhe të kenë mundësi që të marrin pjesë gjatë intervistimit publik.

Intervistimi publik i kandidatëve për drejtorë a zëvendës drejtorë bëhet në ambientet IEAA përkatës ku kandidatët kanë konkurruar dhe ku janë përzgjedhur për t'u intervistuar.

Intervista me secilin kandidat duhet të zgjasë 25-35 minuta, ku secili kandidat duhet të ketë në dispozicion së paku 20 minuta për prezantimin e vetes dhe mbrojtjen e Planit Zhvillimor 4-vjeçar për zhvillimin e IEAA-së, ndërsa minutat tjerë përdoren për pyetje-përgjigje nga Komisioni për kandidatin.

Për vlerësimin e kandidatëve, gjatë gjithë procesit të përzgjedhjes së drejtorit a zëvendës drejtorit të IEAA-së, anëtarët e Komisionit bazohen dhe i plotësojnë formularët përkatës që janë të paraparë në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2014.

Pas përfundimit të intervistimit publik të kandidatëve, komisioni e përgatitë ranglistën e kandidatëve dhe, bazuar në rezultatin e vlerësimit, i rekomandon kryetarit të komunës kandidatin për t'u përzgjedhur drejtor a zëvendës drejtor i IEAA-së.

Kryetari i komunës e miraton propozimin e Komisionit gjithmonë, përveç rasteve kur ka dyshime të bazuara se ka pasur parregullsi gjatë procesit të vlerësimit dhe në rastet kur ndonjëri nga anëtarët e Komisionit dorëzon ankesë me shkrim për jokorrektesi gjatë procesit të vlerësimit. Në këto raste kryetari i komunës mund të kërkojë intervistimin dhe vlerësimin e sërishëm të kandidatëve.

Pas miratimit të propozimit të Komisionit nga ana e kryetarit të komunës, kandidati i përzgjedhur njoftohet dhe informohet për kushtet e kontratës dhe datën e fillimit të punës.

Pas përzgjedhjes së kandidatëve si drejtorë a zëvendës drejtorë të IEAA-ve, publikohet lista e të përzgjedhurve finalë në ueb faqen e komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Drejtorive të IEAA
- DKA-së
- QSHQK



Drejtori
J. Thaçi
Jusuf Thaçi

Prishtinë, më
27 qershor 2014